



# THIRRJA E PARË E HAPUR PËR PROPOZIME PËR FONDIN E ARTEVE NDËRKULTURORE RINORE

E hapur për:	Organizatat e shoqërisë civile, Komunat, Fondacionet kulturore.
Mundësi financimi:	Deri në 7000 EUR për aplikim/thirrje
Periudha e implementimit:	Qershor 2023 - Maj 2024
Afati i dorëzimit:	30 prill 2023

## Udhëzime për aplikantët për grante

### Ndërtimi i urave të reja

Projekti “Ndërtimi i urave të reja” (NUR) ndërlidhet me Fondin për ndërtimin e urave të reja (NUR) për periudhën 2014-2021, i cili paraqiti një model për arsimin e integruar në Maqedoninë e Veriut duke mbështetur shkollat, komunat dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) për të bashkuar fëmijët me prejardhje dhe gjuhë të ndryshme përmes aktiviteteve të përbashkëta mësimore (kurrikulare).

Ky projekt i ri synon më tej ndërtimin e shoqërive gjithëpërfshirëse që ushqejnë dhe krenohen me pluralizmin kulturor dhe respektin për tolerancën, dialogun dhe bashkëpunimin, në një klimë besimi dhe mirëkuptimi të ndërsjellë si garanci më të mira të paqes dhe sigurisë sociale.

NUR aktualisht mbështetet nga Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Polonisë dhe Dukata e Madhe e Luksemburgut.

### Objektivi i Fondit për artet ndërkulturore rinore (FANR)

**Objektivi i përgjithshëm i Fondit për artet ndërkulturore rinore (FANR)** është të forcojë kapacitetin e të rinjve pavarësisht dallimeve etnike për të promovuar dialogun ndëretnik, vlerat qytetare dhe për të luftuar diskriminimin përmes aktiviteteve të bazuara në art dhe iniciativave ndërkulturore. FANR do të shpërndajë grante për OSHC-të e përzgjedhura që punojnë me djem dhe vajza dhe organizatat kulturore me një përvojë të pasur në fushën e fuqizimit të të rinjve dhe promovimit të vlerave qytetare përmes artit dhe aktiviteteve ndërkulturore.

Prioritetet e Fondit për ANR janë:

1. Forcimi i marrëdhënieve ndëretnike dhe bashkëpunimit midis fëmijëve dhe të rinjve me prejardhje të ndryshme gjuhësore dhe kulturore përmes aktiviteteve të përbashkëta;
2. Nxitja e respektit të ndërsjellë dhe luftimi i stereotipeve dhe paragjykimeve etnike duke zhvilluar një ndjenjë komuniteti dhe përkatësie;
3. Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e angazhimit qytetar si mjet për integrim;
4. Promovimi i artit si mjet për komunikim ndërkulturor dhe mirëkuptim të ndërsjellë.

Mund të aplikojnë organizatat e shoqërisë civile, subjektet/fondacionet kulturore dhe komunat.

Në kuadër të thirrjes së parë për propozime, FANR siguron grante deri në 7000 euro për OSHC-të/subjektet kulturore dhe komunat që plotësojnë kushtet për propozim projektet e zbatuara midis Qershor 2023 dhe Maj 2024.

## Paketa e aplikimit

Paketa e aplikimit mund të shkarkohet përmes faqes së Misionit të OSBE-së në Shkup dhe faqes së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Aplikacionet duhet të dorëzohen në gjuhën angleze. Përveç versionit në gjuhë angleze mund të dorëzohet edhe version shtesë në gjuhën maqedonase dhe/ose shqipe. Afati i fundit për Thirrjen e parë të hapur është **30 prill 2023**.

Aplikacionet mund të dërgohen direkt në: [BNB.mk@osce.org](mailto:BNB.mk@osce.org)

Aplikimet fillimisht shqyrtohen nga Zyra Ekzekutive e Fondit NUR për të përcaktuar nëse janë të pranueshme. Një bord i pavarur këshillues merr vendimin përfundimtar për ndarjen e fondit.

Për çdo pyetje në lidhje me thirrjen e hapur mund të kontaktoni ekipin tonë:  
Nëse e keni të vështirë të plotësoni formularin në PDF, mund ta kërkonit me email formularin e aplikimit në format të WORD dokumenti.

Emilija Simonovska | Tel: 070 358083

Florin Rexhepi | Tel: 070 358298

Email: [bnb.mk@osce.org](mailto:bnb.mk@osce.org)

## Objektivi i Fondit të arteve ndërkulturore rinore (FANR)

### Kriteret e pranueshmërisë

#### 1. Pranueshmëria e aplikantit

FANR do të ndajë grante të vogla për OSHC-të e përzgjedhura, qendrat rinore, qendrat kulturore dhe subjektet e tjera të regjistruara ligjërisht (p.sh., komunat) në Republikën e Maqedonisë së Veriut me një përvojë të dëshmuar në fushat e fuqizimit të të rinjve dhe promovimit të vlerave qytetare përmes artit dhe aktiviteteve ndërkulturore.

Propozime projektet e financuara do të administrohen drejtpërdrejt nga OSHC-të përfituese, të kontraktuara nga Misioni si partnerë zbatues dhe do të menaxhohen në përputhje me udhëzimet administrative dhe rregulloret e OSBE-së për partnerët zbatues.

Nëse financohet, në fillim të aktiviteteve të projektit, çdo përfituesi të grantit do t'i kërkohet të kryejë një sondazhë bazë për të matur shkallën fillestare të kohezionit social midis djemve dhe vajzave që marrin pjesë. Më saktë, sondazhi ka për qëllim të masë perceptimet e përkatësisë, përfshirjes, tolerancës dhe pjesëmarrjes si fusha të rëndësishme të kohezionit social. Sondazhi do të zhvillohet nga Njësia NUR dhe do të realizohet më tej nga përfituesit e granteve si partnerë zbatues. Pjesëmarrësve do t'u garantohet fshehtësia e informacionit të dhënë në sondazhin. Të gjitha të dhënat do të ruhen dhe mirëmbahen në mënyrë të sigurt brenda serverit të Misionit. Gjetjet e sondazhit bazë do të futen në raportin përfundimtar të vetëvlerësimit të projektit.

## 2. Pranueshmëria e aktiviteteve e projektit

Aktivitetet e pranueshme duhet të synojnë:

- Avancimin e vlerave të përbashkëta qytetare;
- Inkurajimin e socializimit ndëretnik;
- Promovimin e tolerancës përmes artit dhe nismave kulturore.

Mundësitë janë të pafundme dhe nuk janë vendosur kufij të qartë për sa kohë që pjesëmarrësit e projektit dhe përfituesit me **gjuhë të ndryshme mësimore** angazhohen në mënyrë aktive dhe ndërtohen ura.

Kjo duket e mundur më së shumti kur aktivitetet (p.sh., debatet ndërkulturore; punëtoritë; fushatat; veprimet në komunitet, bisedimet frymëzuese):

- ✓ Çojnë drejt një produkti të dëshiruar të përbashkët (p.sh., grup roku multietnik, shfaqje teatrale, film dokumentar, art mural me grafiti) që rezultojnë nga shpeshësia e kontaktit dhe angazhimit aktiv midis të rinjve pjesëmarrës;
- ✓ Janë **me të vërtetë "të përziera"** me përfaqësim të barabartë të të rinjve me gjuhë të ndryshme mësimore; dhe krijojnë bashkëpunimin midis njëri-tjetrit gjatë ngjarjeve;
- ✓ Përqendrohen në aktivitetet që theksojnë **interesat** e përbashkët, **dhe jo prejardhjet që bëjnë dallimin mes tyre;**
- ✓ **Përfshijnë në mënyrë të barabartë djem dhe vajza**, si dhe të rinj me **nevoja të veçanta**. **Për të gjithë nxënësit, nën 18 vjeç, të përfshirë në aktivitetet e projektit, aplikantët duhet të marrin miratimin e prindërve.**
- ✓ **Përfshijnë politikën;**
- ✓ **Sigurojnë mundësi për komunitetet pakicë dhe të marginalizuara në vendet ku do të zhvillohet aktiviteti;**
- ✓ Bazohen në **interesat e shprehur nga vetë të rinjtë** dhe jo të dizajnuara vetëm nga stafi i OSHC-ve.

## 3. Buxheti

Fondi **Ndërtimi i urave të reja nuk i paguan parat** por blen materialet dhe/ose shërbimet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve sipas rregullave dhe procedurave të Misionit të OSBE-së në Shkup. Aplikanti duhet të japë një vlerësim të shpenzimeve të parashikuara, dhe pas kësaj Zyra Ekzekutive përfundimisht vendos për blerjet e pranueshme. Granti nuk do të mbulojë asnjë shpenzim pune të OSHC-ve (qiranë për zyrat, shpenzimet komunale, etj.).

Projekti është një aktivitet i bashkëfinancuar, ku aplikanti mbulon shpenzimet për zyrat, shpenzimet komunale, ekspertizën e brendshme, etj. Shkalla e bashkëfinancimit që aplikanti do të jetë në gjendje

të sigurojë do të jetë një nga kriteret në të cilat Projekti do të mbështetet gjatë vlerësimit të aplikantit/ëve.

### **Konsultime me rininë**

Të gjitha propozim projektet duhet qartë të demonstrojnë pjesëmarrjen e të rinjve në zbatimin e aktiviteteve. Qëllimi i këtij kushti është të sigurohet se të gjitha propozimet përfshijnë aktivitete integruese që vetë të rinjtë i konsiderojnë si më të realizueshme dhe interesante, si dhe të mbështesë zhvillimin e një kulture të shkëmbimit të hapur idesh mes stafit të OSHC-ve dhe të rinjve që marrin pjesë.

### **Bordi këshillues i Fondit të ri për NUR**

Bordi këshillues i Fondit të ri për NUR është organi kryesor që vlerëson aplikimet dhe organi vendimmarrës i gjithë skemës së financimit të NUR, detyra e të cilit është të vlerësojë propozim projektet dhe të marrë vendime për ndarjen e granteve. Parashikohet që Bordi të përbëhet nga Zëvendës Shefi i Misionit të OSBE-së në Shkup, Menaxheri i Projektit të NUR (Shefi i Departamentit të Dimensionit Njerëzor), Oficeri i Lartë për çështje gjinore (ose Zëvendës personi i kontaktit për çështje gjinore, ose një përfaqësues tjetër nga Njësia për çështje gjinore), Oficeri kombëtar i Programit përgjegjës për portofolin e të rinjve, Oficeri i lartë i demokratizimit dhe një përfaqësues nga Njësia e monitorimit.

### **Njoftimi për vendimin**

Aplikantët do të informohen me e-mail për vendimin e Bordit këshillues të fondit NUR në lidhje me aplikimin e tyre. Nëse aplikimi miratohet me kusht, aplikantët do të marrin komentet dhe rekomandimet e Bordit mbi atë se si ta rishikojnë aplikimin. Nëse kërkesa refuzohet, aplikanti do të marrë arsyetimin për vendimin negativ. Aplikimet që janë më tepër në përputhje me objektivat e përcaktuara në këto Udhëzime, që kanë cilësinë më të lartë, ndikimin e pritur, qëndrueshmëri dhe efektivitet të kostos, do të kenë shans më të madh për të fituar grantin.

\* \* \*



## FORMULARI I APLIKIMIT

<b>Titulli i projektit</b>							
<b>Aplikanti</b>							
<b>I. Profili i aplikantit</b>							
(emri i plotë i aplikantit)							
Emri i organizatës në anglisht							
Shkurtësë në ANG, MQ ose SHQ							
Statusi ligjor							
Adresa e subjektit							
Komuniteti në të cilin operon njësia							
Data e regjistrimit të organizatës							
Numri amë							
Numri unik tatimor (UTN)							
Përfaqësuesi(t) ligjor(ë) <sup>1</sup> Emri i plotë				Numri i telefonit			
E-maili							
Menaxheri i projektit <sup>2</sup> Emri i plotë				Numri i telefonit			
E-maili							
(Nëse ka) Persona të tjerë të përfshirë Emri i plotë				Numri i telefonit			
E-maili							
(Persona të tjerë të përfshirë) Emri i plotë				Numri i telefonit			
Emaili							
Faqja e internetit e organizatës/subjektit				Faqja në Twitter			
Faqja në LinkedIn				Faqja në Facebook			
Faqja në Instagram				Platforma të tjera të mediave sociale			
Tregoni nivelin e punës të organizatës				Cilat janë 3 prioritetet kryesore të organizatës/subjektit tuaj?			
<b>KAPACITETI OPERACIONAL</b>	2022	2021	2020	<b>KAPACITETI FINANCIAR</b>	2022	2021	2020
Numri i punonjësve				Të hyrat vjetore			
Numri i anëtarëve				Shpenzime vjetore			
Numri i vullnetarëve							
Zyrat dhe ambientet e punës							
Emri i partnerit nëse planifikoni të përfshini ndonjë				Faqja e internetit/mediat sociale të partnerit			
Aktivitetet ekzistuese dhe/ose të mëparshme të përbashkëta me partnerin/partnerët, nëse ka							

shënoni çdo fond ekzistues dhe/ose të mëparshëm të marrë nga OSBE-ja		Shuma totale e fondeve të kërkuara në MKD	
<b>II. Rëndësia e propozimit të projektit</b>			
Ju lutemi, përshkruani veprimin që dëshironi të zbatoni. Përshkruani shkurtimisht të gjitha aktivitetet që propozoni. Mos hyni në shumë detaje dhe mos i tregoni aktivitetet që janë zbatuar në të kaluarën.			
Ju lutemi përshkruani shkurtimisht mjedisin/situatën aktuale sociale dhe ndëretnike në komunitetin/zonën tuaj në të cilën veproni. Identifikoni dhe përshkruani problemet dhe/ose nevojat kryesore midis djemve dhe vajzave me prejardhje të ndryshme etno-kulturore që dëshironi të adresoni përmes këtij projekti. Shpjegoni se si ky projekt do të trajtojë këto probleme dhe çfarë ndryshimesh dhe ndikimi (pasojat afatgjata) dëshironi të arrini. <i>[Maksimumi gjysmë faqe]</i>			
<b>III. Objektivi i përgjithshëm</b>			
Përshkruani qëllimin e objektivit të projektit tuaj (qëllimi i përgjithshëm që dëshironi të arrini me këtë projekt). Objektivi duhet të adresojë nevojat dhe problemet e identifikuara më sipër. Duhet të jetë S.M.A.R.T. dhe të nxjerrë në pah qëllimin për t'u arritur. Ju lutemi vini re se objektivi duhet të jetë në përputhje me objektivin e përgjithshëm të Fondit të arteve ndërkulturore rinore siç përshkruhet në Udhëzimin.			
<b>IV. Rezultatet</b>			
Në fjali konkrete tregoni rezultatin specifik që duhet të arrihet nga projekti. Rezultati duhet të jetë një produkt konkret i dalë nga aktivitetet e propozuara. (p.sh., shfaqje teatrale, film dokumentar, art mural grafiti etj.) Ju lutemi jepni tregues konkretë që do të masin se në çfarë shkalle është arritur rezultati.			

<sup>1</sup> Nëse aplikanti nuk është një organizatë, në vend të emrit të Drejtorit, ju lutemi jepni emrin dhe kontaktin e zyrtarit përgjegjës.

<sup>2</sup> Menaxheri i projektit është personi përgjegjës për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të propozuara dhe për hartimin dhe dorëzimin e Raportit narrativ final pas përfundimit të projektit

## V. Plani i aktiviteteve

### V.1. Aktiviteti

Aktivitetet janë veprime që lidhen me dhënien e rezultateve të projektit përgjatë përmbushjes së objektivit të përgjithshëm. Ju lutemi jepni një përshkrim të detajuar të çdo aktiviteti që propozoni ta zbatoni. Shpjegoni se si aktiviteti çon drejt arritjes së rezultateve të caktuara (metodologjia). Sigurohuni që të keni marrë parasysh dimensionin gjinor dhe multikulturor në përshkrimin e aktiviteteve.

Pyetje udhëzuese:

- (i) Çfarë (tregoni llojin e aktivitetit: p.sh., debat, podcast, punëtori arti etj.);
- (ii) Kush (përshkruani se cilët janë përfituesit e këtij aktiviteti dhe në çfarë mënyre janë të përfshirë);
- (iii) Kur (kohëzgjatja e aktivitetit);
- (iv) Ku (siguroni lokacionin ku do të mbahet aktiviteti)
- (v) Pse (shpjegoni lidhjen e aktivitetit me objektivat dhe rezultatet e aktivitetit) dhe
- (vi) Si (qasja dhe plani juaj për të zbatuar këtë aktivitet).

#### Aktiviteti 1 (Emri i aktivitetit)

## V.2. Kush është i përfshirë?

[Ju lutemi, jepni detaje në lidhje me të rinjtë që do të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e projektit.]

Aktiviteti	Numri total i të rinjve të përfshirë	Numri i përfituesve të projektit	Mosha e përfituesve të projektit	Përfaqësimi gjinor Numri i djemve dhe vajzave	Përfaqësimi i komuniteteve etnike dhe/ose kulturore

## VI. Përfshirja e të rinjve në hartimin e aktiviteteve të projektit

A kontribuon projekti i propozuar në realizimin e potencialit të individëve, duke lejuar që të rinjtë pjesëmarrës të përfshihen në hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve? A do të kontribuojnë aktivitetet në përvetësimin e aftësive të reja dhe edukimin e kapitalit shoqëror dhe kulturor? Përkrahuni se si aktiviteti prodhon miqësi dhe bashkëpunime të reja të qëndrueshme. Ju lutemi përkrahuni se si do të siguroni përfaqësim të barabartë dhe përfshirje të grupeve të ndryshme në aktivitetet tuaja.

## VII. Plani i dukshmërisë

Ju lutemi përkrahuni se si do të siguroni dukshmërinë e aktiviteteve të projektit (p.sh. postime në faqen e internetit të organizatës suaj, faqen e Facebook-ut, etj.). Specifikoni gjithashtu gjuhën/ët që do të përdorni për të siguruar dukshmërinë e aktiviteteve të projektit.



**VIII. Kuadri kohor**

[Vendosni vetëm "X" në fushë me muajin kur planifikoni të zbatoni aktivitetin.]

[Muajt numërohen sipas asaj që propozimi juaj parashikon për zbatimin e aktiviteteve.]

[Nëse keni më shumë aktivitete sesa kuti më poshtë, shtoni më shumë kuti. Nëse keni më pak, fshini kutitë që nuk ju nevojiten.]

Aktiviteti	Muaji											Vendi i zbatimit të aktivitetit		
	Qershor 2023 (M1)	Korrik 2023 (M2)	Gusht 2023 (M3)	Shtator 2023 (M4)	Tetor 2023 (M5)	Nëntor 2023 (M6)	Dhjetor 2023 (M7)	Janar 2024 (M8)	Shkurt 2024 (M9)	Mars 2024 (M10)	Prill 2024 (M11)	Maj 2024 (M12)		

**IX. Qëndrueshmëria**

Qëndrueshmëria financiare: Si do të financohen dhe/ose ndërtohen aktivitetet e ardhshme të integruara mbi rezultatet e këtij projekti pasi të përfundojë financimi i NUR?

Qëndrueshmëria institucionale: Çfarë lloj strukturash/mekanismash për komunikim dhe bashkëpunim të ndërtuar si rezultat i fondit do të jenë në dispozicionin tuaj për të çuar më tej rezultatet e arritura pasi të ketë skaduar granti? Si do të përdoren këto mekanizma për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen?

Qëndrueshmëria shoqërore: Si do të ushqehen dhe zhvillohen lidhjet e vendosura midis fëmijëve dhe /ose të rinjve në të ardhmen? Cili do të jetë roli i institucionit/organizatës përfituese të projektit në këtë veprim? Çfarë lloj aktiviteteesh parashikoni të zbatoni në të ardhmen për të çuar më tej këto lidhje? A do të përdoren platformat e mediave sociale për komunikimin në të ardhmen?

Sinergji me aktivitete të tjera: A planifikoni të bashkëfinanconi ose bashkoni këtë aktivitet me ndonjë projekt/program tjetër të organizatës suaj?

#### X. Për çfarë keni nevojë?

[Na tregoni se çfarë ju nevojitet. Mendoni për të gjitha gjërat që do t'ju nevojiten për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve. Mendoni për pajisjet, blerjet, shërbimet, tarifat, komisionet, transportin etj. Jini të detajuar dhe realistë. Mos lini asgjë jashtë, sepse nëse pika nuk është në buxhetin e kërkuar, ne nuk mund të sigurojmë fonde shtesë për të.]

[Nëse keni më shumë linja buxhetore sesa linjat më poshtë, shtoni më shumë rreshta. Nëse keni më pak, fshini hapësirat që nuk ju nevojiten.] Lirisht shtoni rreshta për nën-pika poshtë çdo pike (psh. 3.1. Aktivitet vizatimi; 3.1.3. Shkumësa)]

Ju lutemi, deklaroni aktivitetet në të njëjtën mënyrë si në V. Plani i aktiviteteve. Numroni rreshtet sipas aktiviteteve. Materialet e nevojshme për zbatimin e secilit aktivitet duhet të deklarohen nën të (p.sh. për zbatimin e Aktivitetit 1 nën V.1.6 Vizita në Operën dhe Baletin e Maqedonisë, duhet të përfshini kostot e transportit nën seksionin 2.Transporti, ndërsa kostot e tjera si biletat e hyrjes, pijet freskuese, ushqimin etj. duhet të deklarohen si 3.1.1., 3.1.2., 3.1.3...).

Pika	Njësia	Nr. i njësive	Kostoja për artikull	Kostoja totale
<b>1. Burimet njerëzore</b>				
Totali Burimet njerëzore				
<b>2. Transporti</b>				
Totali Transporti				
<b>3. Aktivitetet</b>				
Totali Aktivitetet				
<b>4. Pajisje</b>				
Totali Pajisje				
<b>5. Të tjera</b>				
Totali Të tjera				
<b>Totali në MKD</b>				